



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:2374/24 Datë: 20.11.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 130 të mbajtur më datë 01.11.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës, për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - o *Kimi PhD 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 5 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës që të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovet me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Kimi PhD 180 ECTS (A)	Sevdije Govori, Fetah Podvorica Tahir Arbnesi, Musaj Paçarizi

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit AKA ka organizuar vizitat në Universitetin e Prishtinës me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. **Për programin e studimit; Kimi PhD 180 ECTS**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: *Milan Pol, Bruno Zelic dhe Matej Drobnic* është organizuar më 11.09.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht të gjitha fushat e standardeve të përcaktuara me Manualin e Standardeve për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 130-të, të mbajtur më datë 01.11.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematikë – Natyrore të Universitetit të Prishtinës;
- **MASHTI**;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë